

## AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUARA

#### “NEW BRIDGE” SH.P.K

##### Neni 1

##### Emërtimi dhe ortakët e Shoqërisë

Sot, në Tiranë, në datën **14 maj 2018** me vullnetin e lirë Ortakët e Shoqërisë:

Arjodita Rraboshta, shtetase shiptare, e lindur më **12.07.1985** në Shkodër, Shqipëri, e pajisur me pashaportë me numër **032663694** dhe me numër personal identifikimi **I55712097Q**.

Fleino Mozali, shtetas shqiptar, lindur me **31.05.1989**, në Shkodër, Shqipëri, i pajisur me kartën e identitetit **032940802** dhe me numër personal identifikimi **I905310830**.

Vendosen : Të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë “NEW BRIDGE” SH.P.K, më poshtë e quajtur si “Shoqëria”.

##### Neni 2

##### Selia e Shoqërisë

Shoqëria do ta ketë selinë e saj në Rr.” Muhamet Gjollështa”, Pallati nr.69, Shk.2, Ap.1. Tiranë.

##### Neni 3

##### Kohëzgjatja e Veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë do të jetë **20 vjet** të njëpasnjëshëm, por me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, ky afat mund të ripërtërihet.



#### Neni 4

##### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 100 (njëqind lekë), e cila përfaqëson 100% të kapitalit, të ndare me 2 (kuota).

Ortaku **Fleino Mozali** zotëron **50.5% të kapitalit**, e cila përfaqëson një kuotë me vlerë 50.5 leke, i cili është tërësisht kapital financiar që përbëhet nga kontributi i ortakëve të kompanisë.

Ortaku **Arjodita Rraboshta** zotëron **49.5% të kapitalit**, e cila përfaqëson një kuotë me vlerë 49.5 leke, i cili është tërësisht kapital financiar që përbëhet nga kontributi i ortakëve të kompanisë.

Ortakët kanë të drejtë ta tjetërsojnë këtë kapital, të shtojë apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Secili ortak disponon një kuotë në Shoqëri. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Në rast se një nga ortakët dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t'ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.

Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë ortakët do të kenë të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

#### Neni 5

##### Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj Shoqërie do të jetë:

*Real Estate*



2  


- Aktivitet ndermjetesimi per pasurite e paluajtshme, agjensi imobiliare. Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kane objekt te ngjashem apo te perafert me te vetin. Gjithashtu, brenda kufijve te percaktuar nga ligji mund te leshoje garanci, letra demshperblimi dhe çdo garanci tjeter reale. Shoqeria ne ushrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomik.
- Cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Me zgjerimin e aktivitetit, shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke bërë ndryshimet përkatëse në Statut.

## Neni 6

### Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të Falimentimit të ortakut

Në rast vdekje apo falimenti të njërit prej ortakëve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këro të drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakut. Në rast të refuzimit të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguajë trashëgimtarëve apo personave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke patur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.

Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur orej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.



3



Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit si zotërues i kuotës.

## Neni 7

### Zmadhimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur, nese nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi zmadhimin e kapitalit.

Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjestim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## Neni 8

### Zvogëlimi i Kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, mu kuorumin e përcaktuar në nenin 9 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

Ortakët epërballojnë zvogëlimin e kapitalit të shoqërise, në përpjetim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## Neni 9



4



## ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë më shkrim.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për Komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkurhet procesverbali përkatës.

Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në baze të nenit 84 të ligjit nr .9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërrmarrjet dhe Shoqëritë Tregtare". Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektornike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë)ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.



5



Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9 i këtij Akti themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët më të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 10**

#### **Administratori**

Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një Administrator për një kohëzgjatje prej **5 vjetësh** për periudhën **14.05.2018 deri 13.05.2023**, i cili do të jetë , **Fleino Mozali** , dtl **31.05.1989** , lindur në **Shkoder** , **Shqipëri** dhe me banim në **Tiranë**.

Administratori /t zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.

Asambleja e përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve të Shoqërisë.

#### **Neni 11**

#### **Shpërbërja dhe likuidimi**

Shoqëria shpërbëhet për arsyet e parashikuara nga ligji dhe me:

- a. Për mbarimin e afatit.
- b. Për pëmundësi të funksionimit ose për inaktivitet të vazhduar të asamblesë,

6

- c. Për reduktimin e kapitalit nën minimumin ligjore.
- d. Me vendim të asamblesë e për arsye të tjera të parashikuara me ligj

Në të gjitha hipotezat e shpërbërjes, asambleja e ortakëve, do të caktojë një ose më shumë likuidatorë duke përcaktuar numrin e likujduesve si dhe kriteret në bazë të të cilave do kryhet likuidimi.

## Neni 12

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.

## Neni 13

### Kontrolli Financiar

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në atë rast kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

## Neni 14

### Bilanci Vjetor

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

## Neni 15

### Dividentët



7



Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërise.

#### Neni 16

#### Gjuha

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në **2 (dy)** kopje në gjuhën shqipe.

#### Neni 17

#### Dispozita përfundimtare

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt themeli dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr.9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe Shoqëritë tregtare".

#### Ortakët

**Fleino Mozali**



**Arjodita Rraboshta**

